



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2022:022027

Datë: 06.01.2023

Numri i dokumentit: 03833581

**C.nr.79/2022**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**, gjyqtari **Besmir Juniku**, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësi L. K. nga Rahoveci, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 Euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **06.01.2023** merr këtë:

#### **A K T V E N D I M**

Padia e paditësi L. K. nga Rahoveci, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR.**

#### **A r s y e t i m**

Paditësi L. K. nga Rahoveci, të cilët me autorizim e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi.

Gjykata me Aktvendimin C.nr.79/2022 të datës 07.04.2022, e ka ftuar paditësin që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh ta paguaj taksën gjyqësore për padi, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se i autorizuari i paditësit me datën 27.04.2022 e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës së kërkuar për padinë.

Sipas nenit 253 paragrafi 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas*

*vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e taksës për padi brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim e tij nga pagesa e të njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 253 parag. 5 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,  
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,  
C.nr.79/2022, me datë 06.01.2023.**

**Bashkëpunëtor profesional  
Samir Morina**

**Gj y q t a r i  
Besmir Juniku**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.